



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS  
SENATI AKADEMIK

Nr. 162/Prot.  
18

Tiranë, më 22/05 2020

**V E N D I M**

**Nr. 10, datë 22/05/2020**

**P Ë R**

**PUBLIKIMIN E KËRKESËS PËR APLIKIM PËR ANËTARË NË KOMISIONIN E APELIMIT TË  
UNIVERSITETIT POLITEKNIK TË TIRANËS**

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", Urdhrin nr. 8, datë 14.01.2020 të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë "Për procesin zgjedhor për autoritetet dhe organet drejtuese në institucionet publike të arsimit të lartë", të ndryshuar, Urdhrin Nr. 108, datë 08.05.2020 "Për shtyrjen e datës së zgjedhjeve për autoritete dhe organet drejtuese në institucionet publike të arsimit të lartë për shkak të gjendjes së fatkeqësisë natyrore të shkaktuar nga pandemia COVID – 19", Rregulloren "Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në Universitetin Politeknik të Tiranës" neni 39, pika 2, si dhe urdhrin nr. 43, datë 14.05.2020 të Rektorit të UPT – së "Për vijimin e procedurave për organizimin e zgjedhjeve të autoriteteve dhe organeve drejtuese në Universitetin Politeknik të Tiranës",

**V E N D O S I:**

1. Të shpallë kërkesën për aplikim, për 5 (pesë) anëtarë të Komisionit të Apelit në Universitetin Politeknik të Tiranës.
2. Të drejtën për të aplikuar e kanë individët që plotësojnë kriteret e përcaktuara në nenin 39, pika 2 të Rregullores "Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në Universitetin Politeknik të Tiranës", të miratuar me vendimin nr. 6, datë 12.02.2020 të Senatit Akademik.
3. Regjistrimi i kandidatëve të interesuar, bëhet në Sekretarinë e Senatit (pranë Drejtorisë së Kërkimit Shkencor dhe Projekteve), brenda datës 28.05.2020, ora 13:00.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



KRYETARI  
Prof. Dr. Andrea MALIQARI

UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.4, Tiranë,  
Tel/Fax: +355 4 2227914,  
web: www.upt.al